

ELECTIS CX

"KLASA: 2". Xn, Xi.



"I DËMSHËM. IRRITANT"

I RREZIKSHËM PËR MJEDISIN (N).

Frazat e rrezikut: R43, R43, R50/53, R22.

Frazat e sigurisë: S2, S24, S35, S37, S57.

ELECTIS CX është fungicid sistemik dhe me veprim mbrojtës për luftimin e vrugut në vresht, në domate, patëllxhanë e patate. Zoxamide ka efekt mbrojtës duke penguar formimin e zoosporeve brënda Sporangiumit.

Lenda vepruese: 330gr kg (33 %) zoxamide + 330gr kg (33 %) Cymoxanil.

Formulimi: Granula të dispergueshme në ujë (WG)

Masat parambrojtjese:

- Ruajeni në vënde të sigurta, larg fëmijëve.
- Ruajeni larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Para dhe gjatë punës mos hani dhe mos pini alkoool, lëngje e duhan.
- Gjatë punës vishni rrobat e punës dhe pajisjet mbrojtëse për sytë e lëkurën.
- Lani duart, fytyrën dhe pjesët e ekspozuara të lëkurës pas punës dhe para ushqimit.
- Pas punës lani pajisjet mbrojtëse, mjetet e spërkatjes.
- Bëni asgjësimin e ambalazhit sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me sytë dhe lëkurën, të lahen me ujë të bollshëm e sapun.
- Në rast helmimi me gëlltije, personi vendoset në vënde të ajrosura. Menjëherë drejtoheni tek mjeku ose në qendrën mjekësore më të afërt.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

Përdoret në:

- *vresht (për tavolinë dhe verë)*. Doza 35-40gr në 100 litra ujë. Të trajtohet pasi vreshti të ketë krijuar 4 fletë dhe masën vegetative ta spërkasim çdo 7-10 ditë.

- *patate*. Doza 45gr/100 litra ujë dhe spërkasim masën vegetative kur lastari ka vajtur 5 cm.

- *perime (domate dhe patëllxhan)*, Doza 40-45gr/100 litra ujë dhe spërkatja e parë të bëhet kur bima është në fletën e tretë duke e spërkatur të gjithë masën vegetative.

Për luftimin e vrugjeve numri maksimal i trajtimeve në të gjitha kulturat është 3 (tre).
Trajtimet bëhen kur kushtet e motit favorizojnë semundjet dhe përpara çfaqjes së saj, pasi vepron në mënyrë të veçantë duke e ndaluar sëmundjen.

Mënyra e përgatitjes së preparatit:

Mbushni pompën spërkatëse me ujë deri në gjysëm, hidhni dozën e preparatit, përzijeni mirë dhe pastaj shtoni sasinë tjetër të ujit. Pas spërkatjes pastrojeni mirë pompën me ujë të bollshëm.

Ndikimi në ekosistem:

Shumë toksik për ujërat e ndenjura. Mbani një distancë prej 20 m larg ujërave dhe kulturave të tjera kur spërkatni. Mos ndotni burimet ujore, që perdoren për ujë, për qelime shtëpiake etj., me ambalazhet ose solucionin spërkatës. Asgjësoni ambalazhet dhe meturinat e preparatit sipas rregullave në fuqi.

Karenca:

3 dite tek domatja; 7 ditë tek patatja dhe kulturat e tjera; 28 ditë tek rrushi.

Magazini:

Preparati ruhet në kuti të mbyllura, në vënde të thata e të ftohta. Në vëndin e ruajtjes të mos kalojë temperatura më shumë se 35^o C. Preparati të mos mbahet në diell, lagështi e ngrica.

Nr dhe data e regjistrimit **632, datë 23.06.2016.**

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 90, 200 gr.

Bar kod i përkatës:

Data e prodhimit:

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 2 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese:

Tipi i ambalazhit bazë: Material i pa përshkueshëm nga lagështia.

Emri dhe adresa e Aplikantit: ELANCO HELLAS S.A.C.I. **Adresa:** 335 Mesogeion Av.,Chalandri, 15310 Ag.Paraskevi, Athinë , Greqi.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Gowan Comercio Internacional e Servicos Lda. **Adresa:** Rua Ivens, n^o. 3-B Edificio Dona Mécia, 6th floor-9000-046 Funchal-Madeira (Portugali).

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republikën e Shqipërisë): ...